

URDHËR
Nr. 189/1, datë 22.9.2020

PËR KORRIGJIMIN E GABIMEVE MATERIALE NË URDHRIN NR. 189, DATË 22.6.2020, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KONSTITUIMIN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 73, pika 13, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, si dhe të nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative ,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 189, datë 22.6.2020, të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, korrigjohen gabimet materiale si më poshtë:

1. Togfjalëshi “*neni 6*” zëvendësohet me togfjalëshin “*neni 5*” dhe vijon renditja numerike e neneve në vazhdim të urdhrit.

2. Në nenin 9, pika 2, togfjalëshi “*të nenit 10*” zëvendësohet me togfjalëshin “*të nenit 9*” dhe në pikën 3, germa “d”, togfjalëshi “sipas germës “ç”, të pikës 2” zëvendësohet me togfjalëshin “sipas shkronjës “ç”, të pikës 3”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)